

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“INNOVATIVE DENTAL SOLUTION “ SHPK**

Sot me date 27.05.2024, ne seline e shoqerise **“INNOVATIVE DENTAL SOLUTION “ SHPK** me adrese Rr Shefjet Kuka,Nd.31,H.1,njesia administrative nr.4,njesia bashkiake nr.4., ne Tirane nga une i nenshkruari

- Kreshnik Çikaj**, atësia Mustaf, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës numër BF2027890, me numër personal identifikimi I80228098N i datëlindjes 28.02.1988, lindur në Kukës dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Enea Qerama**, atësia Petro, shtetas shqiptar, identifikuar me anë te pasaportës numër BA5019554, me numër personal identifikimi I10113086R i datëlindjes 13.01.1981, lindur në Durres dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Hartova kete Akt Themelimi te shoqerise **“INNOVATIVE DENTAL SOLUTION “ SHPK**, mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:



**KREU 1**  
Neni 1  
Krijimi

Shoqeria **“INNOVATIVE DENTAL SOLUTION “ SHPK**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqeria **“INNOVATIVE DENTAL SOLUTION “ SHPK** eshte një shoqeri, që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.



Neni 3  
Selia

Shoqeria e ka seline Rr Shefjet Kuka,Nd.31,H.1,njesia administrative nr.4,njesia bashkiak nr.4.,Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4  
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte:

- a)Import-Eksport materiale te artikujve te ndryshem dentar.
- b)Tregetim me shumic dhe pakic te artikujve te ndryshem dentar.
- c)Kryeja e veprimtarive dhe/ose pjesemarrja ne çdo veprim ose aktivitet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, apo çdo veprimitari ne lidhje me to, dhe çdo aktivitet ekonomik qe do te konsiderohet i nevojshem dhe i dobishem ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtarise, dhe qe nuk bie ne kundershtim me legjislacionin Shqiptar.

Neni 5  
Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise " INNOVATIVE DENTAL SOLUTION " SHPK eshte e pakufizuar.

KREU II  
KAPITALI

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 lekë (njeqindmije leke).

Ortaku Kreshnik Çikaj eshte zoterues i nje kuote me vlore nominale 50 000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar.

Ortaku Enea Qerama eshte zoterues i nje kuote me vlore nominale 50 000 leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

### Neni 7

#### **Mënyra te fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuota te kapitalit te një shoqerie me perjegjesi te kufizuar te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) kontributit ne kapitalin e shoqeris
- b) shitblerjes
- c) trashegimise
- d) dhurimit
- e) cdo menyre tjeter parashikuar me ligj

1. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate ,kontrata duhet te behet me shkrim.
2. Statuti mund te kushtezoje kalimin e kuotave ,vecanerisht duke percaktuar miratimin e shoqerise ose te drejten e parablerjes ne favor te shoqerise apo te ortakeve te tjere.
3. Nërastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshire momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmérinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

### KREU III

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### Neni 8

#### *Organi Vendimmarres*

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion financier kreditor.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9  
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga Z. Enea Qerama sipas statutit dhe ligjit per një periudhe 5 vjecare me te drejte riperteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

Neni 10  
Kompetencat

Administratori ka tē drejtë e detyrohet tē:

- a) kryejë tē gjitha veprimet e administrimit tē veprimtarisë tregtare tē shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, tē vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e tē rregullt tē dokumenteve dhe tē librave kontabël tē shoqërisë;
- c) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente pérpara asamblesë së përgjithshme pér miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë tē dhënat e detyrueshme tē shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare tē Regjistrimit;
- e) raportojë pérpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve tē posaçme me rëndësi tē veçantë pér veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejëdetyratëtjeratëpërcaktuaranëligjdhënëstatut.

Administratori ka tē drejte tē kryeje tē gjitha veprimet e administrimit tē zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë pérpara tē gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo tē huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo tē huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore tē gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka tē gjitha kompetencat pér tē vepruar në marrëdhënie me tē tretët në emër tē shoqërisë, si perpara Bankave te te gjitha nivele, per te kryer derdhje, terheqje, transfera, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoriteteve Doganore, etj, në tē gjitha rr Ethanat me përjashtim tē kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me tē tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11  
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 12  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plotë me kete statut dhe dispozitat e legjislativit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13  
Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14  
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "**INNOVATIVE DENTAL SOLUTION " SHPK** nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orginale.

**ORTAKET THEMELUAES**

Kreshnik Çikaj



Enea Qerama

